



Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KRU. "GJAKOVA" SH.A. Gjakovë			
Marrë në datën: 13 - 01 - 2022			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	69		

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare nr. 02/L- 123, Statutit dhe akteve nënligjore në K.R.U. "Gjakova" SH.A., Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve, në intervistën e mbajtur me datën 30.12.2021, për zgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv në K.R.U. "Gjakova" SH.A., nxjerr këtë:

V E N D I M

Mbi zgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv në K.R.U. "Gjakova" SH.A.

Për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në K.R.U. "Gjakova" SH.A., sipas konkursit publik me nr.725 të datës 05.11.2021, z. Hasan Krasniqi, prej gjithsejtë 100 pikëve maksimale, është vlerësuar me 87.33% si kandidati më i suksesshëm për këtë pozitë, bazuar në mesataren e pikëve nga paneli intervistues.

Arsyetim

Bordi i Përkohshëm i K.R.U. "Gjakova" SH.A., me kompetencë të plotë konform nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe kërkesave të konkursit publik me nr. 725 të datës 05.11.2021, ka zhvilluar procedurat e nevojshme të rekrutimit me ç'rast u intervistuan 8 kandidatë, ku kandidati më i suksesshëm u tregua z. Hasan Krasniqi, ku prej gjithsejtë 100 pikëve maksimale, është vlerësuar me 87.33% .

Prandaj, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve pas krijimit të kushteve të nevojshme ligjore dhe përmblyljes me sukses të procesit të rekrutimit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Kandidatët e pakënaqur me vendimin për përzgjedhje mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve

Z. Urim Gashi

